



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 13.4.2023

Nr: 2

Ora: 12:00

**UDHËZIM**

**PËR**

**PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR MBLEDHJEN, ADMINISTRIMIN, PUBLIKIMIN E REZULTATIT  
PARAPRAK TË ZGJEDHJEVE DHE MIRATIMIN E MODELEVE TË DOKUMENTEVE QË PËRDOREN PËR  
NXJERRJEN E REZULTATEVE TË ZGJEDHJEVE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE**

Në mbështetje të neneve 19, pika 1, shkronja “n” dhe 2, 119, pika 2, 120, pika 4, 7, 9 dhe 10 dhe 122, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

**U D H Ë Z O J:**

**Neni 1**

**Qëllimi**

Ky Udhëzim ka për qëllim të përcaktojë rregullat që do të zbatohen për mbledhjen, administrimin dhe publikimin e rezultatit paraprak të zgjedhjeve si dhe të miratojë modelet e dokumenteve që përdoren për nxjerrjen e rezultateve të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

**Neni 2**

**Informacioni që dërgohet elektronikisht nga KZAZ-ja në KQZ**

1. Pas marrjes në dorëzim të materialit zgjedhor, KZAZ-ja dërgon elektronikisht në KQZ informacionin për:
  - a) Qendrat e votimit në të cilat zgjedhjet nuk janë zhvilluar, (nëse ka).
  - b) Kutitë e votimit dhe kutitë e materialeve zgjedhore të cilat janë vlerësuar si “Kuti të parregullta”, (nëse ka).
2. Pas plotësimit të tabelave të rezultateve të çdo QV-je, KZAZ-ja dërgon elektronikisht në KQZ nëpërmjet një aplikacioni kompjuterik, informacionin për rezultatin e zgjedhjeve të çdo QV-je për

Data: 13.4.2023 Nr: 2

Ora: 12:00



“Për përcaktimin e rregullave për mbledhjen, administrimin, publikimin e rezultatit paraprak të zgjedhjeve dhe miratimin e modeleve të dokumenteve që përdoren për nxjerrjen e rezultateve të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore”

kandidatët për kryetar bashkie dhe subjektet zgjedhore që kanë paraqitur kandidatë për këshilltar bashkie në mënyrën e përcaktuar në këtë udhëzim.

### Neni 3

#### Përmbajtja e informacionit për rezultatet e zgjedhjeve

1. Informacioni për rezultatin paraprak dërgohet sipas të dhënave në tabelat e rezultateve të plotësuara nga Grupet e Numërimit dhe të dorëzuara në KZAZ.
2. Informacioni duhet të përmbajë domosdoshmërisht për çdo QV:
  - a) numrin e zgjedhësve që kanë votuar, përfshi dhe numrin e grave;
  - b) numrin e fletëve të votimit të papërdorura;
  - c) numrin e fletëve të votimit të dëmtuara;
  - ç) numrin e fletëve të votimit të gjetura në kuti;
  - d) numrin e votave të pavlefshme;
  - dh) numrin e votave të vlefshme;
  - e) numrin e fletëve të votimit të hedhura gabim;
  - ë) shpërndarjen e votave të vlefshme sipas rastit për kandidatët për kryetar dhe për këshillin bashkiak.

### Neni 4

#### Kushtet që duhet të plotësojë aplikacioni kompjuterik për hedhjen, transmetimin dhe publikimin e rezultatit paraprak të zgjedhjeve

1. Aplikacioni kompjuterik për hedhjen, transmetimin dhe publikimin e rezultatit paraprak duhet të njoftojë kur shkelen këto rregulla:
  - a) numri i zgjedhësve që kanë votuar duhet të jetë jo më i madh se numri i zgjedhësve në listën e zgjedhësve;
  - b) numri i fletëve të votimit të gjetura në kuti duhet të jetë i barabartë me numrin e zgjedhësve që kanë votuar;
  - c) numri i fletëve të votimit të gjetura në kuti duhet të jetë i barabartë me shumën e votave të pavlefshme me votat e vlefshme dhe fletët e votimit të hedhura gabim, nëse ka;
  - ç) numri i votave të vlefshme duhet të jetë i barabartë me shumën e votave të vlefshme të shpërndara sipas rastit, për kandidatët për kryetar ose për këshillin bashkiak;
2. Në rast se cenohen rregullat e përmendura në pikën 1, shkronjat “a” dhe “b” të këtij neni dhe pas verifikimeve që bën sekretari i KZAZ-së, rezultoni se mospërputhja vjen nga ndonjë gabim njerëzor i bërë në VNV, lejohet korrigjimi në sistem i shifrave;

3. Në rast se cenohen kushtet e përmendura në pikën 1, shkronjat “a” dhe “b” të këtij neni dhe pas verifikimeve që bën KZAZ-ja, rezulton se mospërputhja nuk vjen si pasojë e gabimeve njerëzore, por pasqyron të dhënat që janë në Procesverbalin e Mbylljes së Votimit plotësuar nga KQV-ja, aplikacioni kompjuterik lejon vazhdimin e procesit duke bërë në sistem shënimin “Mospërputhje”.
4. Aplikacioni kompjuterik nuk duhet të lejojë për asnjë arsye cënimet e rregullave të përmendura në pikën 1, shkronjat “c” dhe “ç” të këtij neni.

## Neni 5

### Përgjegjësia për përcjelljen e informacionit në KQZ

Hedhja e informacionit në aplikacionin kompjuterik si dhe përcjellja e informacionit të përcaktuar në këtë Udhëzim, në KQZ, bëhet nën drejtimin dhe përgjegjësinë e sekretarit të KZAZ-së.

## Neni 6

### Mënyra e dhënies së informacionit për rezultatet nga KZAZ-ja në KQZ

1. KZAZ dërgon në rrugë elektronike në KQZ, për çdo QV, informacionin e përcaktuar në pikën 1, shkronjat “a” dhe “b”, të nenit 2 të këtij Udhëzimi, menjëherë pas marrjes në dorëzim nga KZAZ-ja të kutive të fletëve të votimit dhe kutive me materialet e votimit nga të gjitha KQV-të.
2. KZAZ dërgon në rrugë elektronike në KQZ, për çdo QV, informacionin e përcaktuar në nenin 2, pika 2, të këtij Udhëzimi, menjëherë pas marrjes së tabelës së rezultateve nga GN-ja. Ky proces vazhdon deri në përfundimin e vlerësimit e numërimit të votave dhe dorëzimit të të gjitha tabelave të rezultateve prej GN-ve sipas kësaj mënyre:
  - a) Sekretari i KZAZ-së, pasi ka marrë nga GN-ja të plotësuar me shkrim dore dhe firmosur tabelën e rezultateve të një QV-je, për kandidatët për kryetar bashkie, sipas modelit KQZ-00-26, që i bashkëlidhet këtij Udhëzimi, ia jep atë operatorit të hedhjes së të dhënave.
  - b) Operatori i hedh këto të dhëna në aplikacionin elektronik në kompjuter dhe printon në letër në 5 (pesë) kopje informacionin që ka në formë elektronike. Menjëherë pas printimit aplikacioni elektronik automatikisht bëhet i pa editueshëm/i pa shkrueshëm.
  - c) Tabelat e printuara nga forma elektronike i dorëzohen GN-së nga sekretari i KZAZ-së, për të verifikuar saktësinë e të dhënave.
    - 1) Në rast se informacioni i dhënë me shkrim dore nga GN-ja dhe ai i printuar nga sistemi elektronik janë të njëjta, pasi firmosen tabelat e printuara nga anëtarët e GN-së, sekretari i KZAZ-së fut në sistem kodin personal të tij dhe udhëzon operatorin të dërgojë në rrugë elektronike rezultatet në KQZ.
    - 2) Në rast se informacioni i dhënë me shkrim dore nga GN-ja dhe ai i printuar nga sistemi elektronik janë të ndryshme, numëruesi i parë i GN-së bën korrigjimet me shkrim

dore në një nga fletët e printuara dhe kjo fletë firmoset nga anëtarët e GN-së. Sekretari i KZAZ-së fut në sistem kodin e tij duke e kthyer aplikacionin elektronik në të editueshëm/të shkrueshëm dhe udhëzon operatorin të bëjë korigjimin e të dhënave të pasakta dhe përsëritet procedura e printimit, verifikimit dhe më pas, kur është arritur saktësia, dërgohet në KQZ.

3. Pas transmetimit të të dhënave të rezultateve të QV-së në KQZ, sekretari i KZAZ-së udhëzon operatorin të skanojë tabelën e rezultateve të plotësuar e firmosur nga GN-ja dhe ta transmetojë atë në KQZ
4. Të njëjtat rregulla, si në pikën 2 të këtij neni, zbatohen edhe për tabelat e rezultateve të zgjedhjeve për subjektet zgjedhore që kanë paraqitur kandidatët për këshilltar bashkie, të plotësuar sipas modelit KQZ-00-27, që i bashkëlidhet këtij Udhëzimi.
5. Menjëherë pas përfundimit të procesit të numërimit të të gjitha QV-ve, sekretari i KZAZ-së kërkon nga operatori të printojë nga baza elektronike e të dhënave Tabelën Përmbledhëse Provizore të Rezultateve për ZAZ-në për kandidatët për kryetar bashkie, sipas modelit KQZ-00-28, që i bashkëlidhet këtij Udhëzimi.
6. Të njëjtën gjë sekretari i KZAZ-së kërkon nga operatori edhe për Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve për ZAZ-në për kandidatët për kryetar bashkie, sipas modelit në KQZ-00-29, e krijuar nga hedhja në bazën e të dhënave e rezultateve të të gjitha QV-ve, përfshirë dhe atë të kutisë së votave të hedhura gabim, plotësuar sipas Modelit KQZ-00-32, që i bashkëlidhet këtij Udhëzimi.
6. Pas miratimit nga KZAZ-ja të Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për kandidatët për kryetar bashkie, sekretari i KZAZ-së udhëzon operatorin të skanojë dhe dërgojë në rrugë elektronike në KQZ, Vendimin e KZAZ-së për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve, plotësuar sipas Modelit në KQZ-01-21 ose KQZ-01-22, që i bashkëlidhet këtij Udhëzimi, së bashku me Tabelën Përmbledhëse përkatëse të firmosur nga anëtarët e KZAZ-së.
7. Pas hedhjes në bazën e të dhënave edhe të rezultateve të kutisë së votave të hedhura gabim për subjektet zgjedhore që kanë paraqitur kandidatët për këshilltar bashkie, plotësuar sipas Modelit KQZ-00-33, që i bashkëlidhet këtij Udhëzimi, kryhen të njëjtat veprime si në pikën 5 dhe 6 të këtij neni edhe për Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve për kandidatët për këshilltarë, plotësuar sipas Modelit KQZ-00-30 dhe për Vendimin e KZAZ-së për miratimin e saj, plotësuar sipas Modelit KQZ-01-23, që i bashkëlidhet këtij Udhëzimi.

## Neni 7

### Publikimi i informacionit për rezultatet paraprake

1. Me marrjen e informacionit nga KZAZ-të, KQZ bën publikimin në dinamikë të rezultatit paraprak në rang bashkie, njësie administrative dhe QV-je.
2. Publikimi i informacionit të mësipërm bëhet në faqen e KQZ-së në internet, ndërsa në monitorët e sallës së mediave publikimi bëhet vetëm në rang bashkie.

Data: 13.4.2023 Nr: 2

Ora: 12:00



“Për përcaktimin e rregullave për mbledhjen, administrimin, publikimin e rezultatit paraprak të zgjedhjeve dhe miratimin e modeleve të dokumenteve që përdoren për nxjerrjen e rezultateve të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore”

3. Rezultatet paraprake jepen në numër votash të vlefshme, përqindje dhe mandatet përkatëse të fituara sipas rastit, për kandidatët për kryetar dhe subjektet zgjedhore që kanë paraqitur kandidatë për këshilltar bashkie.
4. Rezultati paraprak i publikuar nga KQZ-ja, në çdo rast, shoqërohet me numrin gjithsej të QV-ve në zonën përkatëse zgjedhore, me numrin e QV-ve mbi të cilin është llogaritur rezultati i dhënë dhe me shënimin që ky rezultat është paraprak.

## Neni 8

### Prodhimi dhe administrimi i modeleve të dokumenteve për rezultatet

Modelet e dokumenteve që përdoren për nxjerrjen e rezultateve të zgjedhjeve të përmendura në këtë Udhëzim prodhohen, administrohen dhe kanë formate si më poshtë:

1. Të gjitha tabelat e rezultateve të përmendura në këtë Udhëzim para printohen duke patur në përmbajtje sipas rastit, kandidatët për kryetar apo subjektet zgjedhore që kanë paraqitur kandidatë për këshilltar bashkie, ashtu siç janë në fletën e votimit të bashkisë përkatëse.
2. Të gjitha modelet e tabelave të rezultateve si për qendrën e votimit dhe ato përmbledhëse të përmendura në këtë Udhëzim, prodhohen në format A3, letër e thjeshtë.
3. Modelet e vendimeve të KZAZ-së, KQZ-01-21, KQZ-01-22 dhe KQZ-01-23, prodhohen në format A4, letër e thjeshtë.
4. Tabela e rezultateve për QV-në si dhe ajo për fletët e votimit të hedhura gabim, të printuara në 5 (pesë) kopje dhe të firmosura nga anëtarët e GN-së, pas verifikimit të saktësisë, u jepen, kopja e parë me shenjë dalluese nga të tjerat, KZAZ-së dhe të tjerat anëtarëve të GN-së. Anëtarëve të KZAZ-së si dhe vëzhguesve të subjekteve zgjedhore, nëse i kërkojnë, u jepen fotokopje të vulosura nga sekretari i KZAZ-së me vulën e KZAZ-së.
5. Tabela e rezultateve për QV-në, të printuara dhe e firmosur nga GN-ja dhe tabelat e rezultateve të plotësuara me shkrim dore nga GN-ja, i bashkëngjiten njëra-tjetrës, shërbejnë si dokumentacion zyrtar dhe dorëzohen dorazi nga KZAZ-ja në KQZ, së bashku me Tabelat Përmbledhëse të Rezultateve për ZAZ-në si dhe tabelat e rezultateve për fletët e votimit të hedhura gabim.
6. Tabela Përmbledhëse e Rezultateve për ZAZ-në si për kandidatët për kryetar, dhe për subjektet zgjedhore që kanë paraqitur kandidatë për këshilltar bashkie, firmosur nga anëtarët e KZAZ-së, shërbejnë si origjinale dhe i dorëzohen KQZ-së së bashku me tabelat e rezultateve të QV-ve. Kopje të Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve, të vulosura nga sekretari i KZAZ-së me vulën e KZAZ-së, u jepen anëtarëve të KZAZ-së dhe vëzhguesve të subjekteve zgjedhore, nëse i kërkojnë.

## Neni 9

### Dispozita të fundit

1. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
2. Kundër këtij udhëzimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**



QARKU: \_\_\_\_\_

KZAZ Nr: \_\_\_\_\_

GN Nr: \_\_\_\_\_

QV Nr: \_\_\_\_\_

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**



**TABELA E REZULTATEVE TË QENDRËS VOTIMIT**  
**PËR KANDIDATËT PËR KRYETAR TË BASHKISË \_\_\_\_\_**

1	Numri i zgjedhësve që kanë votuar	gjithsej			
		femra			
2	Fletë votimi të papërdorura				
3	Fletë votimi të dëmtuara				
4	Fletë votimi të gjetura në kuti				
5	Vota të pavlefshme				
6	Vota të vlefshme				
7	Fletë të hedhura gabim				

**SHPËRNDARJA E VOTAVE TË VLEFSHME**

Nr	Kandidatët për kryetar (emri, atësia, mbiemri)	Numri i votave të vlefshme	
		Me shifër	Me fjalë
1			
2			
3			
4			
5			
6			
7			
	Gjithsej vota të vlefshme		

**Kundërshtimet e anëtarëve të GN (në se ka)**

1. Unë \_\_\_\_\_, anëtar i GN nr.\_\_\_\_, kundërshtoj tabelën për asye se: \_\_\_\_\_  
(emër, atësi, mbiemër)

\_\_\_\_\_

2. Unë \_\_\_\_\_, anëtar i GN nr.\_\_\_\_, kundërshtoj tabelën për asye se: \_\_\_\_\_  
(emër, atësi, mbiemër)

\_\_\_\_\_

3. Unë \_\_\_\_\_, anëtar i GN nr.\_\_\_\_, kundërshtoj tabelën për asye se: \_\_\_\_\_  
(emër, atësi, mbiemër)

\_\_\_\_\_

Nr.	Numri i kodeve të vulave që mbyllet kutia e votimit
1	
2	
3	
4	
5	

Data e plotësimit \_\_\_\_\_.2023

Grupi i Numërimit Nr.\_\_\_\_

Nr.	Emri, Atesia, Mbiemri	Funksioni	Firma
1		Numërues i parë	
2		Sekretar	
3		Anëtar	
4		Anëtar	



**QARKU:** \_\_\_\_\_  
**KZAZ Nr:** \_\_\_\_\_  
**GN Nr:** \_\_\_\_\_  
**QV Nr:** \_\_\_\_\_

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
 KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE



**TABELA E REZULTATEVE TË QENDRËS SË VOTIMIT  
 PËR KËSHILLIN E BASHKISË \_\_\_\_\_**

1	Numri i zgjedhësve që kanë votuar	gjithsej			
		femra			
2	Fletë votimi të papërdorura				
3	Fletë votimi të dëmtuara				
4	Fletë votimi të gjetura në kuti				
5	Vota të pavlefshme				
6	Vota të vlefshme				
7	Fletë të hedhura gabim				

**SHËRNDARJA E VOTAVE TË VLEFSHME**

Nr	Subjektet Zgjedhore	Numri i votave të vlefshme	
		Me shifër	Me fjalë
1			
2			
3			
4			
5			
6			
7			
8			
9			
10			
11			
12			
13			
14			
15			
16			
17			
18			
19			
20			
21			
22			
23			
24			
25			
26			
27			
28			
29			
30			
31			
32			
	Gjithsej vota të vlefshme		

**Kundërshtimet e anëtarëve të GN (në se ka)**

1. Unë \_\_\_\_\_, anëtar i GN nr.\_\_\_\_, kundërshtoj tabelën për asye se: \_\_\_\_\_  
 (emër, atësi, mbiemër)

2. Unë \_\_\_\_\_, anëtar i GN nr.\_\_\_\_, kundërshtoj tabelën për asye se: \_\_\_\_\_  
 (emër, atësi, mbiemër)

3. Unë \_\_\_\_\_, anëtar i GN nr.\_\_\_\_, kundërshtoj tabelën për asye se: \_\_\_\_\_  
 (emër, atësi, mbiemër)

Nr.	Numri i kodeve të vulave që mbyllet kutia e votimit
1	
2	
3	
4	
5	

Data e plotësimit \_\_\_\_\_.2023

Grupi i Numërimit Nr.\_\_\_\_

Nr.	Emri, Atesia, Mbiemri	Funksioni	Firma
1		Numërues i parë	
2		Sekretar	
3		Anëtar	
4		Anëtar	





**QARKU:** \_\_\_\_\_  
**KZAZ Nr:** \_\_\_\_\_  
**GN Nr:** \_\_\_\_\_

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
 KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE



TABELA E REZULTATEVE E FLETËVE TË VOTIMIT TË HEDHURA GABIM  
 PËR KRYETAR TË BASHKISË \_\_\_\_\_

**Kutia me fletë votimi të hedhura gabim**

1	Fletë votimi të gjetura në kuti			
2	Vota të pavlefshme			
3	Vota të vlefshme			

**SHPËRNDARJA E VOTAVE TË VLEFSHME**

Nr	Kandidatët për kryetar (emri, atësia, mbiemri)	Numri i votave të vlefshme	
		Me shifër	Me fjalë
1			
2			
3			
4			
5			
6			
7			
	Gjithsej vota të vlefshme		

**Kundërshtimet e anëtarëve të GN (në se ka)**

1. Unë \_\_\_\_\_, anëtar i GN nr.\_\_\_\_, kundërshtoj tabelën për asye se: \_\_\_\_\_  
 (emër, atësi, mbiemër)

2. Unë \_\_\_\_\_, anëtar i GN nr.\_\_\_\_, kundërshtoj tabelën për asye se: \_\_\_\_\_  
 (emër, atësi, mbiemër)

3. Unë \_\_\_\_\_, anëtar i GN nr.\_\_\_\_, kundërshtoj tabelën për asye se: \_\_\_\_\_  
 (emër, atësi, mbiemër)

Nr.	Numri i kodeve të vulave që mbyllet kutia e votimit
1	
2	
3	
4	
5	

Data e plotësimit \_\_\_\_\_.2023

**Grupi i Numërimit Nr.\_\_\_\_**

Nr.	Emri, Atesia, Mbiemri	Funksioni	Firma
1		Numërues i parë	
2		Sekretar	
3		Anëtar	
4		Anëtar	



**QARKU:** \_\_\_\_\_

**KZAZ Nr:** \_\_\_\_\_

**GN Nr:** \_\_\_\_\_

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**



**TABELA E REZULTATEVE PËR FLETËT E VOTIMIT TË HEDHURA GABIM**

**Për këshillin e bashkisë \_\_\_\_\_**

**Kutia me fletë votimi të hedhura gabim**

1	Fletë votimi të gjetura në kuti				
2	Vota të pavlefshme				
3	Vota të vlefshme				

**SHPËRNDARJA E VOTAVE TË VLEFSHME**

Nr	Subjektet Zgjedhore	Numri i votave të vlefshme			
		Me shifër		Me fjalë	
1					
2					
3					
4					
5					
6					
7					
8					
9					
10					
11					
12					
13					
14					
15					
16					
17					
18					
19					
20					
21					
22					
23					
24					
25					
26					
27					
28					
29					
30					
31					
32					
	Gjithsej vota të vlefshme				

**Kundërshtimet e anëtarëve të GN (në se ka)**

1. Unë \_\_\_\_\_, anëtar i GN nr.\_\_\_\_, kundërshtoj tabelën për asye se: \_\_\_\_\_  
(emër, atësi, mbiemër)

2. Unë \_\_\_\_\_, anëtar i GN nr.\_\_\_\_, kundërshtoj tabelën për asye se: \_\_\_\_\_  
(emër, atësi, mbiemër)

3. Unë \_\_\_\_\_, anëtar i GN nr.\_\_\_\_, kundërshtoj tabelën për asye se: \_\_\_\_\_  
(emër, atësi, mbiemër)

Nr.	Numri i kodeve të vulave që mbyllet kutia e votimit
1	
2	
3	
4	
5	

**Data e plotësimit** \_\_\_\_\_.2023

**Grupi i Numërimit Nr.\_\_\_\_**

Nr.	Emri, Atesia, Mbiemri	Funksioni	Firma
1		Numërues i parë	
2		Sekretar	
3		Anëtar	
4		Anëtar	



**QARKU:** \_\_\_\_\_

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE



**KZAZ Nr:** \_\_\_\_\_

**TABELË PËRMBLEDHËSE PROVIZORE E REZULTATEVE  
PËR KANDIDATËT PËR KRYETAR TË BASHKISË \_\_\_\_\_**

1	QV-të që pasqyrohen në këtë tabelë	QV nr _____	QV nr _____	QV nr _____	QV nr _____	QV nr _____	QV nr _____	QV nr _____	QV nr _____	Shuma njësi	Me fjalë
2	Numri i zgjedhësve që kanë votuar	gjithsej									
		femra									
3	Fletë votimi të papërdorura										
4	Fletë votimi të dëmtuara										
5	Fletë votimi të gjetura në kuti										
6	Vota të pavlefshme										
7	Vota të vlefshme										
8	Fletë votimi të hedhura gabim										

**SHPERNDARJA E VOTAVE TE VLEFSHME**

Nr.	Kandidatët për kryetar (emri, atësia, mbiemri)	QV nr _____	QV nr _____	QV nr _____	QV nr _____	QV nr _____	QV nr _____	QV nr _____	QV nr _____	Shuma njësi	Me fjalë
1											
2											
3											
4											
5											
6											
7											
	Gjithsej vota të vlefshme										

Kryetar  
(emer, mbiemer, firme)

Zv/Kryetar  
(emer, mbiemer, firme)

Anetar  
(emer, mbiemer, firme)

Anetar  
(emer, mbiemer, firme)

Anetar  
(emer, mbiemer, firme)

Anetar  
(emer, mbiemer, firme)

Anetar  
(emer, mbiemer, firme)

faqe e fundit

ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14.05.2023

Model KQZ 0028 miratuar me Udhëzim të Komisionit Nr.2, dt.13.04.2023



**QARKU:** \_\_\_\_\_

**KZAZ Nr:** \_\_\_\_\_

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**



**TABELË PËRMBLEDHËSE PROVIZORE E REZULTATEVE**

**PËR KANDIDATËT PËR KRYETAR TË BASHKISË \_\_\_\_\_**

1	QV-të që pasqyrohen në këtë tabelë	QV nr _____	QV nr _____	QV nr _____	QV nr _____	QV nr _____	QV nr _____	QV nr _____	QV nr _____	QV nr _____	QV nr _____	QV nr _____	QV nr _____
2	Numri i zgjedhësve që kanë votuar	gjithsej											
		femra											
3	Fletë votimi të papërdorura												
4	Fletë votimi të dëmtuara												
5	Fletë votimi të gjetura në kuti												
6	Vota të pavlefshme												
7	Vota të vlefshme												
8	Fletë votimi të hedhura gabim												

**SHPERNDARJA E VOTAVE TE VLEFSHME**

Nr.	Kandidatët për kryetar (emri, atësia, mbiemri)	QV nr _____	QV nr _____	QV nr _____	QV nr _____	QV nr _____	QV nr _____	QV nr _____	QV nr _____	QV nr _____	QV nr _____	QV nr _____	QV nr _____
1													
2													
3													
4													
5													
6													
7													
	Gjithsej vota të vlefshme												

Kryetar  
(emer, mbiemer, firme)

Zv/Kryetar  
(emer, mbiemer, firme)

Anetar  
(emer, mbiemer, firme)

Anetar  
(emer, mbiemer, firme)

Anetar  
(emer, mbiemer, firme)

Anetar  
(emer, mbiemer, firme)

Anetar  
(emer, mbiemer, firme)

faqe \_\_\_\_



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE



**QARKU:** \_\_\_\_\_

**KZAZ Nr:** \_\_\_\_\_

TABELË PËRMBLEDHËSE E REZULTATEVE

**PËR KANDIDATËT PËR KRYETAR TË BASHKISË** \_\_\_\_\_

1	QV-të që pasqyrohen në këtë tabelë	QV nr _____	QV nr _____	QV nr _____	QV nr _____	QV nr _____	QV nr _____	QV nr _____	Vota të hedhura gabim	Shuma njësi	Me fjalë
2	Numri i zgjedhësve që kanë votuar	gjithsej							X X   X X   X X		
		femra							X X   X X   X X		
3	Fletë votimi të papërdorura								X X   X X   X X		
4	Fletë votimi të dëmtuara								X X   X X   X X		
5	Fletë votimi të gjetura në kuti										
6	Vota të pavlefshme										
7	Vota të vlefshme										
8	Fletë votimi të hedhura gabim								X X   X X   X X		

**SHPERNDARJA E VOTAVE TE VLEFSHME**

Nr.	Kandidatët për kryetar (emri, atësia, mbiemri)	QV nr _____	QV nr _____	QV nr _____	QV nr _____	QV nr _____	QV nr _____	QV nr _____	Vota të hedhura gabim	Shuma njësi	Me fjalë
1											
2											
3											
4											
5											
6											
7											
	Gjithsej vota të vlefshme										

Kryetar  
(emer, mbiemer, firme)

Zv/Kryetar  
(emer, mbiemer, firme)

Anetar  
(emer, mbiemer, firme)

Anetar  
(emer, mbiemer, firme)

Anetar  
(emer, mbiemer, firme)

Anetar  
(emer, mbiemer, firme)

Anetar  
(emer, mbiemer, firme)

faqe e fundit



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE



**QARKU:** \_\_\_\_\_

**KZAZ Nr:** \_\_\_\_\_

**TABELA PËRMBLEDHËSE E REZULTATEVE  
PËR KANDIDATËT PËR KRYETAR TË BASHKISË \_\_\_\_\_**

1	QV-të që pasqyrohen në këtë tabelë	QV nr _____	QV nr _____	QV nr _____	QV nr _____	QV nr _____	QV nr _____	QV nr _____	QV nr _____	QV nr _____	QV nr _____	QV nr _____	QV nr _____
2	Numri i zgjedhësve që kanë votuar	gjithsej											
		femra											
3	Fletë votimi të papërdorura												
4	Fletë votimi të dëmtuara												
5	Fletë votimi të gjetura në kuti												
6	Vota të pavlefshme												
7	Vota të vlefshme												
8	Fletë votimi të hedhura gabim												

**SHPERNDARJA E VOTAVE TE VLEFSHME**

Nr.	Kandidatët për kryetar (emri, atësia, mbiemri)	QV nr _____	QV nr _____	QV nr _____	QV nr _____	QV nr _____	QV nr _____	QV nr _____	QV nr _____	QV nr _____	QV nr _____	QV nr _____	QV nr _____
1													
2													
3													
4													
5													
6													
7													
	Gjithsej vota të vlefshme												

Kryetar  
(emer, mbiemer, firme)

Zv/Kryetar  
(emer, mbiemer, firme)

Anetar  
(emer, mbiemer, firme)

Anetar  
(emer, mbiemer, firme)

Anetar  
(emer, mbiemer, firme)

Anetar  
(emer, mbiemer, firme)

Anetar  
(emer, mbiemer, firme)

faqe —



**QARKU:** \_\_\_\_\_

**KZAZ Nr:** \_\_\_\_\_

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**



**TABELË PËRMBLEDHËSE E REZULTATEVE**

**PËR KANDIDATËT PËR KËSHILLIN E BASHKISË \_\_\_\_\_**

1	QV-të që pasqyrohen në këtë tabelë	QV nr	QV nr	QV nr	QV nr	QV nr	QV nr	QV nr	QV nr	QV nr	QV nr	QV nr	Vota të hedhura gabim	Shuma njësi	Shuma me fjalë
2	Numri i zgjedhësve që kanë votuar	gjithsej											X X X		
		femra											X X X		
3	Fletë votimi të papërdorura												X X X		
4	Fletë votimi të dëmtuara												X X X		
5	Fletë votimi të gjetura në kuti														
6	Vota të pavlefshme														
7	Vota të vlefshme														
8	Fletë votimi të hedhura gabim												X X X		

**SHPERNDARJA E VOTAVE TE VLEFSHME**

Nr	Subjektet zgjedhore	QV nr	QV nr	QV nr	QV nr	QV nr	QV nr	QV nr	QV nr	QV nr	QV nr	QV nr	Vota të hedhura gabim	Shuma njësi	Shuma me fjalë
1															
2															
3															
4															
5															
6															
7															
8															
9															
10															
11															
12															
13															
14															
15															
16															
17															
18															
19															
20															
21															
22															
23															
24															
25															
26															
27															
28															
29															
30															
31															
32															
	Gjithsej vota të vlefshme														

Kryetar  
(emer, mbiemer, firme)

Zv/Kryetar  
(emer, mbiemer, firme)

Anetar  
(emer, mbiemer, firme)

Anetar  
(emer, mbiemer, firme)

Anetar  
(emer, mbiemer, firme)

Anetar  
(emer, mbiemer, firme)

Anetar  
(emer, mbiemer, firme)



**QARKU** \_\_\_\_\_  
**KZAZ NR** \_\_\_\_\_



**TABELË PËRMBLEDHËSE E REZULTATEVE**  
**Për kandidatët për këshill të Bashkisë** \_\_\_\_\_

1	QV-të që pasqyrohen në këtë tabelë	QV nr	QV nr	QV nr	QV nr	QV nr	QV nr	QV nr	QV nr	QV nr	QV nr	QV nr	QV nr	QV nr	QV nr	QV nr	QV nr	QV nr	
2	Numri i zgjedhësve që kanë votuar	gjithsej																	
		femra																	
3	Fletë votimi të papërdorura																		
4	Fletë votimi të dëmtuara																		
5	Fletë votimi të gjetura në kuti																		
6	Vota të pavlefshme																		
7	Vota të vlefshme																		
8	Fletë votimi të hedhura gabim																		

**SHPERNDARJA E VOTAVE TE VLEFSHME**

Nr	Subjektet zgjedhore	QV nr	QV nr	QV nr	QV nr	QV nr	QV nr	QV nr	QV nr	QV nr	QV nr	QV nr	QV nr	QV nr	QV nr	QV nr	QV nr	QV nr	
1																			
2																			
3																			
4																			
5																			
6																			
7																			
8																			
9																			
10																			
11																			
12																			
13																			
14																			
15																			
16																			
17																			
18																			
19																			
20																			
21																			
22																			
23																			
24																			
25																			
26																			
27																			
28																			
29																			
30																			
31																			
32																			
33																			
	Gjithsej vota të vlefshme																		

Kryetar  
(emer, mbiemer, firme)

Zv/Kryetar  
(emer, mbiemer, firme)

Anetar  
(emer, mbiemer, firme)

Anetar  
(emer, mbiemer, firme)

Anetar  
(emer, mbiemer, firme)

Anetar  
(emer, mbiemer, firme)

Anetar  
(emer, mbiemer, firme)

faqe \_\_\_\_





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KZAZ nr.	
Qarku	

VENDIM
Nr:
Datë:
Ora:

PËR MIRATIMIN E TABELËS PËRMBLEDHËSE TË REZULTATEVE PËR  
ZGJEDHJEN E KRYETARIT TË BASHKISË \_\_\_\_\_

(për bashkitë teritori i të cilave mbulohet nga një ZAZ)

Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor Nr. \_\_\_\_\_, Qarku \_\_\_\_\_, në mbledhjen e  
tij të datës \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2023, shqyrtoi çështjen me:

**OBJEKT:** Miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve të Zonës së  
Administrimit Zgjedhor Nr. \_\_\_\_\_, Qarku \_\_\_\_\_ për  
zgjedhjen e kryetarit të bashkisë \_\_\_\_\_, në zgjedhjet e datës 14 maj  
2023.

**BAZA LIGJORE:** Neni 33, pika “ë” dhe “g”, 122, pika 3, i Ligjit nr.10019, datë  
29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i  
ndryshuar.

Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor, pasi shqyrtoi hap pas hapi procesin e nxjerrjes së  
rezultateve për subjektet zgjedhore për \_\_\_\_ QV, pasqyroi rezultatet e të dhënave respektive për çdo  
QV mbi bazën e tabelave origjinale të rezultateve të grupeve të numërimit,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjet për kryetar të bashkisë  
\_\_\_\_\_, bashkalidhur këtij Vendimi, me \_\_ faqe dhe të shpallë fitues  
z/znj. \_\_\_\_\_ propozuar nga

(emri i partisë, koalicionit ose kandidat i propozuar nga zgjedhësit)

2. Tabelat origjinale të rezultatit të çdo QV-je, te plotësuara nga GN-të, janë pjesë integrale e këtij  
vendimi dhe së bashku me Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve, të dërgohen menjëherë në KQZ.



Nr	Emër Mbiemer	Pozicioni	Pro/kundër	Firma
1		Kryetar		
2		Zv/ Kryetar		
3		Anëtar		
4		Anëtar		
5		Anëtar		
6		Anëtar		
7		Anëtar		

### MENDIMI I PAKICËS

1. Unë \_\_\_\_\_, jam kundër këtij vendimi për arsye se

---



---



---

2. Unë \_\_\_\_\_, jam kundër këtij vendimi për arsye se

---



---



---

3. Unë \_\_\_\_\_, jam kundër këtij vendimi për arsye se

---



---



---

VULA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KZAZ nr.	
Qarku	

VENDIM
Nr:
Datë:
Ora:

PËR MIRATIMIN E TABELËS PËRMBLEDHËSE TË REZULTATEVE PËR  
ZGJEDHJEN E KRYETARIT TË BASHKISË \_\_\_\_\_

(për bashkitë teritori i të cilave mbulohet nga më shumë se një ZAZ)

Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor Nr. \_\_\_\_\_, Qarku \_\_\_\_\_, në mbledhjen e  
tij të datës \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2023, shqyrtoi çështjen me:

**OBJEKT:** Miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve të Zonës së  
Administrimit Zgjedhor Nr. \_\_\_\_\_, Qarku \_\_\_\_\_ për  
zgjedhjen e kryetarit të bashkisë \_\_\_\_\_, në zgjedhjet e datës 14 maj  
2023.

**BAZA LIGJORE:** Neni 33, pika “ë”, 122, pika 3, i Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008  
“Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor, pasi shqyrtoi hap pas hapi procesin e nxjerrjes së  
rezultateve për subjektet zgjedhore për \_\_\_\_ QV, pasqyroi rezultatet e të dhënave respektive për çdo  
QV mbi bazën e tabelave origjinale të rezultateve të grupeve të numërimit,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjet për kryetar të bashkisë  
\_\_\_\_\_, bashkalidhur këtij Vendimi, me \_\_ faqe.
2. Tabelat origjinale të rezultatit të çdo QV-je, te plotësuara nga GN-të, janë pjesë integrale e këtij  
vendimi dhe së bashku me Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve, të dërgohen menjëherë në KQZ.

Nr	Emër Mbiemer	Pozicioni	Pro/kundër	Firma
1		Kryetar		
2		Zv/ Kryetar		
3		Anëtar		
4		Anëtar		
5		Anëtar		
6		Anëtar		
7		Anëtar		

### MENDIMI I PAKICËS

1. Unë \_\_\_\_\_, jam kundër këtij vendimi për arsye se

---



---



---

2. Unë \_\_\_\_\_, jam kundër këtij vendimi për arsye se

---



---



---

3. Unë \_\_\_\_\_, jam kundër këtij vendimi për arsye se

---



---



---

VULA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KZAZ nr.	
Qarku	

VENDIM
Nr:
Datë:
Ora:

PËR MIRATIMIN E TABELËS PËRMBLEDHËSE TË REZULTATEVE PËR  
ZGJEDHJEN E KËSHILLIT TË BASHKISË \_\_\_\_\_

Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor Nr. \_\_\_\_\_, Qarku \_\_\_\_\_, në mbledhjen e  
tij të datës \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2023, shqyrtoi çështjen me:

**OBJEKT:** Miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve të Zonës së  
Administrimit Zgjedhor Nr. \_\_\_\_\_, Qarku \_\_\_\_\_ për  
zgjedhjen e këshillit të bashkisë \_\_\_\_\_, në zgjedhjet e datës 14 maj  
2023.

**BAZA LIGJORE:** Neni 33, pika “ë”, 122, pika 3, i Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008  
“Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor, pasi shqyrtoi hap pas hapi procesin e nxjerrjes së  
rezultateve për subjektet zgjedhore për \_\_\_\_ QV, pasqyroi rezultatet e të dhënave respektive për çdo  
QV mbi bazën e tabelave origjinale të rezultateve të grupeve të numërimit,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjet për këshillit të bashkisë  
\_\_\_\_\_, bashkalidhur këtij Vendimi, me \_\_ faqe.
2. Tabelat origjinale të rezultatit të çdo QV-je, te plotësuara nga GN-të, janë pjesë integrale e këtij  
vendimi dhe së bashku me Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve, të dërgohen menjëherë në KQZ.

Nr	Emër Mbiemer	Pozicioni	Pro/kundër	Firma
1		Kryetar		
2		Zv/ Kryetar		
3		Anëtar		
4		Anëtar		
5		Anëtar		
6		Anëtar		
7		Anëtar		

### MENDIMI I PAKICËS

1. Unë \_\_\_\_\_, jam kundër këtij vendimi për arsye se

---



---



---

2. Unë \_\_\_\_\_, jam kundër këtij vendimi për arsye se

---



---



---

3. Unë \_\_\_\_\_, jam kundër këtij vendimi për arsye se

---



---



---

VULA